<p>planifikimi menaxhues duhet t'i marrë parasysh kërkesat për ruajtjen e kafshëve të egra dhe objektivat për menaxhim të qëndrueshëm të gjuetisë.</p> <p>4. Kushtet dhe masat e detajuara për sigurimin e baraspeshës biologjike, mbrojtjen e kafshëve e egra – gjuetinë, ruajtjen e vendbanimeve të kafshëve të egra dhe zgjerimin, rregullohen me akt nënligjor nga Ministria në përputhje me këtë Ligj, Ligjin për Gjuetinë, dhe Ligjin për Mbrojtje të Natyrës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Mbrojtja e llojeve pyjore të rralla dhe të rrezikuara</p> <p>1. Me rastin e planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve silvikulturore dhe të shfrytëzimit, kujdes i veçantë duhet kushtuar ruajtjes së habitateve të llojeve të mbrojtura dhe të rrezikuara.</p> <p>2. Ndalohet prerja e llojeve të rralla dhe të mbrojtura të drunjve, përveç nëse kjo është e domosdoshme për arsye sanitare, prerje të kujdesshme apo përtëritje natyrore të këtyre llojeve, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e habitateve të tyre natyrore.</p> <p>3. Çdo aktivitet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, duhet përfshirë në planet dhe programet menaxhuese të pyjeve.</p> <p>4. Listën e llojeve dhe habitateve pyjore të rralla dhe të rrezikuara me propozim të</p>	<p>treba imati u vidu zahteve za zaštitu divljih životinja i ciljeve za održivo upravljanje lovom.</p> <p>4. Uslovi i detaljne mere za obezbeđivanje biološke ravnoteže, zaštitu divljih životinja – lov, očuvanje staništa divljih životinja i proširenje, regulišu se podzakonskim aktom od strane Ministarstva u skladu sa ovim Zakonom, Zakonom o lovu i Zakonom za Zaštitu Prirode.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Zaštita retkih i ugroženih šumskih vrsta</p> <p>1. Povodom planiranja i realizacije šumarskih aktivnosti i aktivnosti korišćenja, posebna pažnja se treba posvetiti očuvanju staništa zaštićenih i ugroženih vrsta.</p> <p>2. Zabranjuje se seča retkih i zaštićenih vrsta drveća, osim ako je isto neophodno iz sanitarnih razloga, za seče nege ili prirodnu obnovu ovih vrsta, kako bi se osigurala zaštita njihovih prirodnih staništa.</p> <p>3. Svaka aktivnost iz stava 1 i 2 ovog člana treba se obuhvatiti u upravnim planovima i programima šuma.</p> <p>4. Listu retkih i ugroženih vrsta šumskih staništa izdaje Ministarstvo na predlog</p>	<p>planning and operations shall take into account wildlife conservation requirements and sustainable hunting management objectives.</p> <p>4. Conditions and detailed measures for the providing of biological equilibration, protection of wild animals – hunting, protection of dwellings of wild animals and extension, shall be regulated by sub legal act by the Ministry in accordance with this Law, Law on Hunting and the Law on Natural Protection.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Conservation of rare and endangered forest species</p> <p>1. During the planning and implementation of silviculture and forest utilisation activities, special attention shall be given to conservation of protected and endangered habitats and species.</p> <p>2. It is forbidden to cut protected and endangered tree species, unless this is necessary for sanitary reasons, tending cutting or natural regeneration of these species, in order to ensure conservation of their natural habitats.</p> <p>3. Any activity referred to in Paragraph 1 and 2 of this article shall be included in Forest management plans and programs.</p> <p>4. The list of rare and endangered forest species and habitats proposed by the Agency is issued</p>
--	--	--

<p>Agjencisë e nxjerrë Ministria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Menaxhimi i pyjeve brenda zonave të mbrojtura dhe atyre të konservuara</p> <p>1. Brenda zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë të destinuara për shfrytëzim të qëndrueshëm të të mirave natyrore, menaxhimi bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e natyrës, me udhëzimet e Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, me marrëveshjet ndërkombëtare, dhe legjislacionin vendor.</p> <p>2. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni përveç tjerash përfshijnë prerjen e kujdesshme të pyjeve dhe ripërtëritjen natyrore të tyre, duke aplikuar llojet e lejuara të prerjeve, në mënyrë që të mundësohet konservimi dhe kushte të favorshme për ekosisteme pyjore dhe habitate.</p> <p>3. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të përfshihen në planin menaxhues të pyjeve të ndërlidhura për këto zona.</p>	<p>Agencije.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Gazdovanje šumama unutar zaštićenih zona i one koje su konzervisane</p> <p>1. Unutar zaštićenih prirodnih zona koje su namenjene za održivo korišćenje prirodnih dobare, gazdovanje se vrši u skladu odredbe Zakona za zaštitu prirode, sa uputstvima Međunarodne Unije za Očuvanje Prirode, zajedno sa međunarodnim sporazumima i domaćim zakonodavstvom.</p> <p>2. Mere iz stava 1 ovog člana, osim ostalog, obuhvataju i pažljivo seču šuma i prirodnu obnovu iste, primenom dozvoljenih vrsta seče, kako bi se omogućila zaštita i povoljni uslovi za šumske ekosisteme i staništa.</p> <p>3. Mere iz stava 1 ovog člana trebaju se obuhvatiti u planovima gazdovanje šuma koji se odnose na ove zone.</p>	<p>by the Ministry.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Forest management within protected and conserved areas</p> <p>1. Within any protected areas which are intended for sustainable use of natural resources, forest management shall comply with any guidelines of the provisions of the Law on natural protection, with International Union for Conservation of Nature, any applicable international agreements and national legislation.</p> <p>2. The measures referred to in Paragraph 1 of this Article include, among others, forest tending cutting and natural regeneration using approved types of cutting, in order to enable conservation and favorable conditions of forest ecosystems and habitats.</p> <p>3. The measures referred to in Paragraph 1 of this Article shall be included into forest management plans related to these areas.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 49 Rrjedha e ujërave në pyje</p> <p>1. Ndalohet ndryshimi i rrjedhës së ujit dhe shfrytëzimi i çfarëdo burimi ujqor në pyje dhe toka pyjore, përveç në rastet kur është e domosdoshme që të sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit për nevojat e botës së gjallë në pyje.</p>	<p style="text-align: center;">Član 49 Protok vode u šume</p> <p>1. Zabranjuje se izmena toka vode i korišćenje bilo kakvog izvora vode u šumi, osim u slučajevima kada je neophodno obezbediti dovoljnu količinu vode za potrebe živog sveta u šumi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Flow of waters in forests</p> <p>1. It is forbidden to change the flow of water and use of any water spring in forests and forest lands, except when it is necessary to secure a sufficient quantity of water for environmental needs of the forests.</p>

<p>2. Çdo projekt i rregullimit të ujërave në pyje që realizohet sipas ligjeve të veçanta obligohet të ketë pëlqimin e Ministrisë.</p> <p>KAPITULLI VI</p> <p>KULTIVIMI I PYJEVE</p> <p>Neni 50 Përzgjedhja dhe damkosja e drunjëve për prerje</p> <p>1. Përzgjedhja dhe damkosja e drunjëve për prerje bëhet prej personit të autorizuar nga Agjencia, në përputhje me planet dhe programet për menaxhimin e pyjeve si dhe planet nga Neni 28 i këtij Ligji.</p> <p>2. Prerja e drunjëve bëhet vetëm pasi të bëhet përzgjedhja, damkosja dhe shënjimi i tyre për prerje në përputhje me këtë Ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të këtij Ligji.</p> <p>3. Damkosjen e drunjëve për prerje në pyjet e larta e kryen vetëm personi që ka kualifikim profesional Bsc i pylltarisë.</p> <p>4. Në pyjet e ulëta, damkosjen e drunjëve për prerje mund ta kryej edhe tekniku i pylltarisë me shkollim të mesëm në fushën e pylltarisë, që ka së paku 3 vite përvojë pune në punët profesionale në pylltari.</p> <p>5. Masa drunore e përzgjedhur për prerje që kanë diametër në lartësi gjoksi, më pak se 10 cm, nuk ka nevojë të kenë damkë pyjore, por ato</p>	<p>2. Svaki projekat za regulisanje voda u šumama, realizuje se na osnovu posebnih zakona a potrebno je imati i saglasnost Ministarstva.</p> <p>POGLAVLJE VI</p> <p>GAJENJE ŠUMA</p> <p>Član 50 Odabir i doznaka stabala za seču</p> <p>1. Odabir i doznaka stabala za seču vrši lice ovlašćeno od strane Agencije, u skladu sa planovima i programima za gazdovanje šumama, kao i planovima iz Člana 28 Ovog Zakona.</p> <p>2. Seča drveća se vrši samo nakon što se izvrši selekcija, doznaka i obeležavanje istih za seču, u skladu sa ovim Zakonom i podzakonskim aktima izdatih na osnovu ovog Zakona.</p> <p>3. Doznaku drveća za seču u visokim šumama, vrši Bsc šumarstva.</p> <p>4. U niskim šumama, doznaku drveća za seču se može izvršiti i od strane šumarskog tehničara sa srednjim obrazovanjem u oblasti šumarstva, koji poseduje najmanje 3 godine radnog iskustva u stručnim radovima šumarstva.</p> <p>5. Drvna masa izabrana za seču, čiji je precnik na prsnoj visini je manji od 10 cm, ne treba se doznaciti šumskim žigom, nego se obeležavaju</p>	<p>2. The consent of the Ministry shall be required for any project regulating waters springs in the forests, subject to any special laws.</p> <p>CHAPTER VI</p> <p>SILVICULTURE</p> <p>Article 50 Selection and marking of trees for cutting</p> <p>1. Selection and marking of woods for cutting shall be done by the authorised person by the Agency, in accordance with the plans and programs for management of forests as well as the Plans from Article 28 of this law.</p> <p>2. Cutting of trees may be done only after their selection, marking and recording is done in accordance with this Law and any sub – legal acts issued under this Law.</p> <p>3. Marking of trees for cutting in the high forests may be done only by a Bsc forestry.</p> <p>4. Marking of trees for cutting in low coppice forests may also be done by a technician with secondary forestry education and at least 3 years of working experience in professional activities in forestry.</p> <p>5. Tree measure selected for cutting which has a diameter lower than 10 cm at breast height, does not need to be marked with a marking</p>
---	--	--

<p>shënjohen me ngjyrë.</p> <p>6. Damkosja në pyje private kryhet vetëm në prani të pronarit apo të autorizuarit të tij. Para realizimit të damkosjes, zyrtari profesional i autorizuar obligohet që pronarit të pyllit t'i ofrojë këshillat e nevojshme profesionale në lidhje me menaxhimin e pyllit të tij dhe legjislacionin e aplikueshëm.</p> <p>7. Në pyje private damkosja kryhet vetëm nëse pronari i pyllit ofron dëshmi për pronësinë dhe kufijtë e ngastrës.</p> <p>8. Agjencia është institucioni i vetëm në Republikën e Kosovës që është e autorizuar të disponoj dhe përdorë damkat pyjore.</p> <p>9. Mënyra dhe procedurat e damkosjes, forma për evidentimin e drunjëve të damkosur dhe përmbajtja e çekanëve dhe lloji i ngjyrës për damkosje të drunjëve, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p>	<p>bojom.</p> <p>6. Doznaka u privatnim šumama se vrši samo u prisustvu vlasnika ili njegovo ovlašćenog lica. Pre doznake ovlašćeni stručni službenik je obavezan da vlasniku pruži neophodne stručne savete u vezi sa upravljanjem šumom i primenljivim zakonodavstvom.</p> <p>7. Doznaka u privatnim šumama se vrši samo ako vlasnik šume pruži dokaz o vlasništvu i granicama parcele.</p> <p>8. Agencija je jedina institucija u Republici Kosovo koja je ovlašćena da raspolaže i koristi šumske žigove za doznaku.</p> <p>9. Način i procedure doznake, oblik evidentiranja obeležnog drveća i sadržaj čekića i vrste boje koja se koristi za doznaku drveća, određuje se podzakonskim aktom Ministarstva.</p>	<p>hammer and may be marked by color only.</p> <p>6. Marking of trees for cutting in private forests may be done only in the presence of the owner or a person authorized by him/her. Before marking, the authorized professional officer shall provide professional advices as necessary to the forest owner with regard to the management of his/her forest and applicable legislation.</p> <p>7. The marking of trees for cutting in private forests shall be done only if the owner of forests offers evidence of ownership and of the boundaries of the parcel.</p> <p>8. Agency is the only institution in the Republic of Kosovo authorized to possess and use the forest mark (stamp).</p> <p>9. Ways and procedures of marking of trees, the form for recording of marked trees, and contents of hammers and color for marking of trees shall be established by sub – legal act of the Ministry.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 51 Ripërtëritja e pyjeve</p> <p>1. Agjencia dhe pronari i pyllit privat obligohen të bëjnë ripërtëritjen natyrore apo artificiale të pyllit sipas planeve dhe programeve përkatëse.</p> <p>2. Ripërtëritja artificiale si pyllëzimi apo</p>	<p style="text-align: center;">Član 51 Obnova šuma</p> <p>1. Agencija i vlasnik privatne šume su u obavezi da vrše prirodno ili veštačko obnavljanje šume prema odgovarajućim planovima i programima.</p> <p>2. Veštačko obnavljanje kao posumljavanja ili</p>	<p style="text-align: center;">Article 51 Forests regeneration</p> <p>1. Agency and private forest owner shall be obliged to naturally or artificially regenerate the forest, according to the relevant plans and programs.</p> <p>2. Artificial regeneration such as afforestation or</p>

<p>farezimi bëhet në harmoni me objektivat e menaxhimit të qëndrueshëm, duke iu dhënë përparësi llojeve autoktone.</p> <p>3. Aktivitete dhe punimet për ripërtëritjen e pyjeve, financohen nga Buxheti i Republikës të Kosovës, pronari, buxheti i komunave, fonde dhe donatorë të ndryshëm.</p> <p>4. Mjetet nga Buxheti i Republikës të Kosovës për aktivitete në ripërtëritjen e pyjeve, dedikohen për:</p> <p>4.1. Për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura në përmirësimin e funksioneve ekologjike, ekonomike dhe sociale të pyjeve.</p> <p>4.2. Përgatitja e dheut dhe grumbujve pyjor për ripërtëritje natyrore;</p> <p>4.3. Pyllëzimet që krijohen pas prerjes së pastër, apo pas djegies së pyllit;</p> <p>4.4. Prerje kujdesimi dhe rrallime të pyjeve natyrale dhe kulturave pyjore;</p> <p>4.5. Grumbullimi i farërave pyjore dhe fidanëve;</p> <p>4.6. Aktivitete të tjera që mund të përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.</p> <p>5. Financimi dhe bashkëfinancimi i aktiviteteve dhe punimeve nga buxheti i shtetit, komunës, fonde dhe donatorë të ndryshëm, duhet të</p>	<p>osemenjivanj se vrše u skladu sa ciljevima održivog upravljanja, dajući prednost autohtonim vrstama.</p> <p>3. Aktivnosti i radovi za obnavljanje šuma finansiraju se iz budžeta Republike Kosovo, vlasnika, budžeta opština, raznih fondova i donatora.</p> <p>4. Sredstva iz budžeta Republike Kosovo za aktivnosti u obnavljanju šuma, namenjuju se za:</p> <p>4.1. Pošumljavanje golih površina radi unapređenja ekoloških, ekonomskih i socijalnih funkcija šume.</p> <p>4.2. Pripremanje zemljanih i šumskih sastojina za prirodno obnavljanje;</p> <p>4.3. Pošumljavanje koje se stvara nakon čistog sečenja ili spaljivanja šume;</p> <p>4.4. Sečenje radi održavanja i obrezivanja prirodne šume i šumskih kultura;</p> <p>4.5. Sakupljanje šumskih semena i sadnica;</p> <p>4.6. Ostale aktivnosti koje se mogu odrediti podzakonskim aktom Ministarstva.</p> <p>5. Finansiranje i sufinansiranje aktivnosti i radova iz državnog budžeta, opštinskog budžeta, raznih fondova i donatora, treba da se</p>	<p>seedling shall take place in line with the objectives of sustainable management, giving priority to autochthonous species.</p> <p>3. Activities and works for forest regeneration shall be funded by the Budget of the Republic of Kosovo, owner, municipal budget, funds and various donors.</p> <p>4. Funds from the Budget of the Republic of Kosovo for forest regeneration activities shall be dedicated to:</p> <p>4.1. Afforestation of bare surfaces in improving ecological, economic and social functions of forests.</p> <p>4.2. Preparing the soil and forest stands for forest regeneration.</p> <p>4.3. Forests created after clear cutting or forest incineration.</p> <p>4.4. Tending cutting and thinning of natural forests and forest crops.</p> <p>4.5. Collection of forest seeds and seedlings.</p> <p>4.6. Other activities as may be stipulated with a bylaw of Ministry.</p> <p>5. Financing and co-financing of activities and works from the budget of state, municipalities, fund and various donors, shall be based on</p>
---	--	--

<p>bazohet në planet dhe programet përkatëse, në përputhje me ligjin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Grumbujt farorë dhe materialet riprodhuese pyjore</p> <p>1. Grumbujt farorë shfrytëzohen dhe menaxhohen për prodhimtarinë e farërave për drunjë pyjor.</p> <p>2. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet për përcaktimin dhe menaxhimin e grumbullit faror, prodhimin e materialit riprodhuese pyjor, tregtimin dhe qarkullimin e këtij materiali.</p>	<p>zasniva u odgovarajućim planovima i programima, u skladu sa zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 52 Semenske sastojine i šumski reproduktivni materijali</p> <p>1. Semenske sastojine se koriste i gazduje za proizvodnju semena za šumsko drveće.</p> <p>2. Ministarstvo podzakonskim aktom određuje uslove za određivanje i upravljanje Semenske sastojine, proizvodnju šumskog reproduktivnog materijala, trgovinu i promet ovog materijala.</p>	<p>relevant plans and programs, in compliance with the law.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Seed stands and forest reproductive materials</p> <p>1. Seed stands used and managed for production of forest tree seeds.</p> <p>2. The Ministry through a sub legal act, defines the conditions for the creation and management of seed stands, for production of forest reproductive materials, marketing and circulation of such material.</p>
<p>KAPITULLI VII</p> <p style="text-align: center;">SHFRYTËZIMI I PYJEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Kushtet për prerjen e pyjeve</p> <p>1. Prerjet ripërtëritëse në pyje lejohen vetëm në kohën e fryt dhënies.</p> <p>2. Koha e realizimit, mënyra dhe llojet e prerjes së pyjeve përcaktohen me planin ose programin për menaxhimin e pyjeve.</p> <p>3. Prerja e drunjëve, rrëzimi dhe tërheqja nga pylli duhet të realizohen në atë mënyrë që nuk rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëtorëve gjatë prerjeve, nuk e dëmtojnë pyllin, tokën dhe nuk e ulin vlerën e materialit drunor.</p>	<p>POGLAVLJE VII</p> <p style="text-align: center;">KORIŠĆENJE ŠUMA</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Uslovi za seču šuma</p> <p>1. Seče obnovljanja u šumama se dozvoljava samo u vreme plodonosenja.</p> <p>2. Vreme realizacije, način i vrste seče šuma, određuju se planom ili programom za upravljanje šumama.</p> <p>3. Seča drveća, obaranje i privlačenje iz šume, treba se izvršiti na način gde se ne ugrozava život ili zdravlje radnika tokom seče i koji nece oštetiti šumu, zemlju i koji ne smanjuje vrednost drvnog materijala.</p>	<p>CHAPTER VII</p> <p style="text-align: center;">FORESTS UTILISATION</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Conditions for forest cutting</p> <p>1. Forest regeneration cuttings in forest are allowed in the time of fructification only.</p> <p>2. Time of realization, manner and types of forest cuttings are defined by Forest management plans or programs.</p> <p>3. Cutting, felling and skidding of timber shall be performed in such a manner as not to endanger the life and health of the workers, not to damage the forest, and not to decrease the value of timber.</p>

<p>4. Ndërmarrjet që bëjnë shfrytëzimin e pyjeve, gjatë aktiviteteve të prerjes së drunjëve, rrëzimit dhe tërheqjes nga pylli obligohen që të zbatojnë standardet e sigurisë së punëtorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Ndalohen punët e rënda dhe të rrezikshme në pyje me të cilët mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre për personat nën moshën 18 vjeçare.</p> <p>6. Mënyra, forma dhe kushtet për realizimin e prerjeve pyjore, rregullohen me akt nënligjor nga Ministria.</p>	<p>4. Preduzeća koja koriste šume, dužna su da tokom aktivnosti seče drveća, obaranja i privlačenja iz šume, sprovedu bezbednosne standarde svojih radnika u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p>5. Osobama mlađih od 18 godina zabranjuju se teški i opasni poslovi u šumi, koji bi mogli ugorziti njihov život i zdravlje.</p> <p>6. Način, oblik i uslovi za realizaciju šumske seče, regulišu se podzakonskim aktom Ministarstva.</p>	<p>4. Companies which operate in forests, during the operations of cutting of woods, fall and stretch from forest are obliged to implement standards of work safety in accordance with the legislation into force.</p> <p>5. Heavy and risky works for the persons less than 18 years of age, by which their life and health can be at risk, are forbidden.</p> <p>6. Manner, form and conditions for performing forest cutting shall be established by sub – legal act of the Ministry.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 54 Mënyrat kontraktuese të shfrytëzimit të pyjeve shtetërore</p> <p>1. Përgjegjësia dhe detyrat për sigurimin e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore realizohen nga Agjencia në përputhje me këtë Ligj.</p> <p>2. Për shfrytëzimin e pyjeve shtetërore që bazohen në planet për menaxhim të pyjeve dhe planet operationale, Agjencia mund t'i përdorë mënyrat kontraktuese si në vijim:</p> <p>2.1. Dhënia e kontratave për shfrytëzimin e pyjeve të cilat përfshijnë shitjen e drurit në këmbë dhe detyrimet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, që mund të përfshijë edhe detyrime për mbrojtje të pyjeve, silvikulturë dhe operatione të tjera pyjore;</p>	<p style="text-align: center;">Član 54 Ugovorni načini korišćenja državnih šuma</p> <p>1. Odgovornost i dužnosti za obezbeđivanje korišćenja državnih šuma Agencija realizuje u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>2. Za korišćenje državnih šuma, koje se zasniva na planovima za upravljanje šumama i operativnim planovima, Agencija može koristiti sledeće ugovorne načine:</p> <p>2.1. Izdavanje ugovora za korišćenje šuma koja obuhvata i prodaju stabala u dubecom stanju i obaveze za izgradnju i održavanje šumske infrastrukture, što može obuhvatiti i obaveze za zaštitu šuma, gajenje i ostale šumarske operacije;</p>	<p style="text-align: center;">Article 54 Contractual mechanisms for state forest utilisation</p> <p>1. The Agency shall be responsible for the utilisation of state forests in accordance with this Law.</p> <p>2. For utilisation of the state forests, which shall be based on forest management plans and operational plans, the following contractual mechanisms may be used by the Agency:</p> <p>2.1. Awarding of contracts for forest utilisation which include selling of standing timber and obligations for building and maintaining of forest infrastructure, and may include also obligations for performing forest protection, silviculture and other forest operations;</p>

<p>2.2. Shitjen e drurit në këmbë në bazë të lejes për prerje;</p> <p>2.3. Dhënia e kontratave për kryerjen e shërbimeve për shfrytëzimin e pyjeve dhe kryerjen e punimeve tjera pyjore;</p> <p>2.4. Shitja e asortimenteve drunore si produkte të kontratave nga nën paragrafi 2.3, të këtij neni.</p> <p>3. Çmimet e drurit në këmbë, produkteve drunore dhe shërbimeve për qëllime nga paragrafi 2 i këtij neni përcaktohen nga Agjencia.</p>	<p>2.2. Prodaja stabala u dubecom stanju na osnovu dozvole za seču;</p> <p>2.3. Davanje ugovora za izvršenje usluga za korišćenje šuma i izvršenje ostalih šumskih radova;</p> <p>2.4. Prodaja drvnog sortimenata kao proizvodi ugovora iz tačke 2.3 ovog člana.</p> <p>3. Cene stabala u dubecom stanju, drvnih proizvoda i usluga za potrebe iz stava 2. ovog člana, određuju se od strane Agencije.</p>	<p>2.2. Selling of standing timber based on cutting permits;</p> <p>2.3. Awarding of contracts for performing forest utilisation and/or other forest operations;</p> <p>2.4. Selling of wood products obtained under the contracts referred to in subparagraph 2.3 of this article.</p> <p>3. The prices of standing timber, wood products and services for purposes of Paragraph 2 of this Article shall be determined by the Agency.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 55 Kushtet për dhënien e kontratave për shfrytëzim të pyjeve</p> <p>1. Autoriteti kontraktues për qëllime sipas paragrafit 2 të Nenit 54 është Agjencia.</p> <p>2. Kontratat mund të jepen për njësitë e menaxhimit të pyjeve, ose pjesët e tyre, për të cilat ekzistojnë planet për menaxhimin e pyjeve, për periudhën deri në 10 vjet apo për periudhën e vlefshmërisë së planeve.</p> <p>3. Kontrata për periudhën deri në pesë (5) vjet mund të jepet për qëllimet e përcaktuara në nën paragrafin 2.3. të Nenit 54 të këtij ligji.</p> <p>4. Kontratat nga nën paragrafi 2.1 dhe 2.3. të Nenit 54 të këtij ligji mund të jepet për subjektet</p>	<p style="text-align: center;">Član 55 Uslovi za davanje ugovora za korišćenje šuma</p> <p>1. Ugovorna vlast za svrhe iz stava 2 člana 54 je Agencija.</p> <p>2. Ugovori mogu se dati za sumske gazdinske jedinice, ili njihovim delovima, za koje postoje planovi za upravljanje šumama, za period do 10 godina ili za period validnosti planova.</p> <p>3. Ugovor za period do pet (5) godina može se dati za svrhe utvrđene tačkom 2.3. člana 54 ovog zakona.</p> <p>4. Ugovori iz tačkaka 2.1 i 2.3. člana 54 ovog zakona mogu se dati za licencirane subjekte,</p>	<p style="text-align: center;">Article 55 Conditions for awarding contracts for forest utilisation</p> <p>1. The contract awarding Authority for the purposes of paragraph 2 of article 54 is the Agency.</p> <p>2. Contracts may be awarded for forest management units or parts thereof for which forest management plans exist, for a period of up to 10 years or the period of validity of the plans.</p> <p>3. Contracts for periods of up to five (5) years may be awarded for the purposes of subparagraph 2.3. of Article 54 of this law.</p> <p>4. Contracts under subparagraph 2.1 and 2.3. of article 54, of this law may be awarded to</p>

<p>e licencuara, të cilat i plotësojnë kushtet e kërkuara për një kontratë të veçantë, sipas ligjit.</p> <p>5. Përmes kontratës nga nën paragrafin 2.1. i Nenit 54 të këtij ligji, pala kontraktuese ka të drejtën për shfrytëzimin e drurit të prerë brenda sasisë së lejueshme, pas damkosjes apo shënjimit të drunjëve për prerje dhe planet operacionale për menaxhimin e pyjeve të jenë hartuar.</p> <p>6. Përmes kontratave nga nën paragrafi 2.3. të Nenit 54, të këtij ligji pala kontraktuese ka të drejtën për kryerjen e punimeve pyjore kundrejt pagesës, të cilat mund të kompensohen pjesërisht ose plotësisht, me të drejtën për shfrytëzimin e drurit në formën e tij në këmbë, në qoftë se një marrëveshje e tillë është arritur që në fillim.</p> <p>7. Të drejtat dhe detyrimet e detajuara për palët kontraktuese, kushtet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe çështjet tjera të nevojshme për kontratë, duke përfshirë përmbajtjen e kontratës së tillë të përbashkët, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 56 Të hyrat nga shfrytëzimi i pyjeve shtetërore</p> <p>1. Të hyrat e realizuara nga kontratat për shfrytëzimin e pyjeve shtetërore dhe shitjen e drurit nga ana e Agjencisë, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.</p>	<p>koji ispunjavaju uslove koji se zahtevaju za posebne ugovore, u skladu sa zakonom.</p> <p>5. Putem ugovora iz tačke 2.1. člana 54 ovog zakona, ugovorna stranka ima pravo da koristi posečeno drvo u dozvoljenoj količini, nakon doznake ili obeležavanja drveća za seču i nakon izrade operativnih planova za upravljanje šumama.</p> <p>6. Putem ugovora iz tačke 2.3. člana 54, ovog zakona ugovorna stranka ima pravo na izvršenje šumskih radova u odnosu na plaćanje, koje se delimično ili u potpunosti mogu nadoknaditi sa pravom korišćenja drveta u stajaćem obliku, ako je sporazum ove vrste postignut još od početka.</p> <p>7. Prava i detaljne obaveze za ugovorne stranke, uslovi i zahtevi ugovornog tela i ostala pitanja neophodna za ugovor, uključujući sadržaj ovakvog zajedničkog ugovora, određuju se podzakonskim aktom Ministarstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 56 Prihodi iz korišćenja državnih šuma</p> <p>1. Prihodi dobijeni iz ugovora za korišćenje državnih šuma i prodaje drva od strane agencije, ulivaju se u Budžet Republike Kosova.</p>	<p>licensed entities which fulfill the required conditions for a specific contract, in accordance with the law.</p> <p>5. By a contract issued under subparagraph 2.1. of Article 54 of this law, a contractor obtains the right to cut wood in the amount specified in it, and may exercise such right after the adoption of applicable Operational plans for forests management and stamping or marking of trees.</p> <p>6. By the contracts issued under sub paragraph 2.3 of Article 54, of this law a contractor obtains the right to carry out forest operations against such payment as may be specified, and such payment may be compensated, partly or in total, with the right for utilisation of standing timber, if such an agreement is reached at the beginning.</p> <p>7. Detailed contractors rights and obligations, conditions and requirements of the contract awarding authority and other necessary contract issues, including required contents of contracts, shall be established by sub legal act of the Ministry.</p> <p style="text-align: center;">Article 56 Incomes from state forests utilisation</p> <p>1. Net revenues collected from the contracts for state forest utilisation and selling of the wood by the Agency shall be considered as income of the Budget of the Republic of Kosovo.</p>
--	---	---

<p>2. Nga të hyrat neto të realizuara me shitjen e masës drunore nga pyjet shtetërore, 30% e tyre i dedikohet buxhetit të komunës nga territori i të cilës këto shuma janë realizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Kushtet për rend pyjor</p> <p>1. Kontraktuesit në shfrytëzimin e pyjeve shtetërore obligohen që punët në shfrytëzimin e pyjeve t'i kryejnë në afatin e përcaktuar, sipas planit operacional duke iu përmbajtur kushteve dhe kërkesave për vendosjen e rendit pyjor.</p> <p>2. Pronarët e pyjeve private obligohen që të kryejnë punët për shfrytëzimin e pyjeve dhe të krijojnë rregull në pyje në përputhshmëri me kushtet dhe afatet e vendosura në lejen për prerje.</p> <p>3. Në rast të çrregullimit të rendit pyjor, shfrytëzuesi apo pronari i pyllit obligohet që në afatin sa më të shkurtër ta rivendosin rendin pyjor.</p> <p>4. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe kushtet për vendosjen e rendit pyjor.</p>	<p>2. Od neto realizovanih prihoda, prodajom drvine mase iz državnih šuma, 30% istih se namenjuje opštinskom budžetu sa teritorije sa koje su ovi prihodi realizovani.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Uslovi za šumski red</p> <p>1. Ugovorači za korišćenje državnih šuma su dužni da radove za korišćenje šuma vrše u određeneom vremenskom roku, na osnovu operativnog plana, pridržavajući se uslova i zahteva za uspostavljanje šumskog reda.</p> <p>2. Vlasnici privatnih šuma su obavezni da izvrše radove na korišćenje šuma i stvore sumski red u šumama u skladu sa uslovima i rokovima određenim u dozvoli za seču.</p> <p>3. U slučaju poremećaja šumskog reda, korisnik ili vlasnik šume je obavezan da u što kraćem vremenskom roku ponovo uspostavi šumski red.</p> <p>4. Ministarstvo podzakonskim aktom određuje načini i uslove za uspostavljanje šumskog reda.</p>	<p>2. From the net incomes realized with the selling of wood measure from state forests, 30% of their dedicated to the budget of the municipality from the territory of which these sums are realized.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Conditions for forest order</p> <p>1. Contractors, for the use of state forests, are obliged to finalize their forest utilisation works within the foreseen time limits, in accordance with the Operational forest management plan, and subject to conditions and requirements for establishing the forest order.</p> <p>2. Private forest owners are obliged to carry out forest utilisation works and establish forest order in accordance with the conditions and terms set out in the cutting permit.</p> <p>3. In case the forest order is disrupted, the contractor or the owner of the forest shall restore it in the shortest time possible.</p> <p>4. Further conditions for establishing the forest order shall be established by sublegal act of the Ministry.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 58 Leja për prerje në pyje private</p> <p>1. Kërkesa për prerje të pyllit privat bëhet nga pronari i pyllit apo i autorizuari dhe dorëzohet në Agjenci.</p>	<p style="text-align: center;">Član 58 Dozvola za seču u privatnim šumama</p> <p>1. Zahtev za seču privatne šume podnosi se od strane vlasnika šume ili ovlašćenog lica i isti se dostavlja agenciji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 58 Cutting permits for private forests</p> <p>1. Application to obtain permits to cut trees in private forests shall be submitted by the forestry's owner or authorized representative to the Agency.</p>

<p>2. Agjencia bën damkosjen dhe shënjimin e drunjëve për prerje apo mund të autorizojë subjektin e licencuar.</p> <p>3. Leja për prerje lëshohet nga Agjencia në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.</p> <p>4. Leja për prerje të pyjeve private përmban, përveç numrit, strukturën e diametrit, vëllimin, llojin dhe cilësinë e masës drunore të shënuar për prerje, si edhe kushtet, kërkesat dhe afatet për kryerjen e operacioneve të nevojshme pyjore, në bazë të këtij Ligji.</p> <p>5. Pronarët e pyjeve private obligohen që të paguajnë një taksë të caktuar si kompensim për lëshimin e lejes për prerje, përfshirë këtu shënjimin e drunjëve për prerje, e cila nuk do të tejkalojnë 10 % të vlerës së masës drunore në cung, e shënuar për prerje.</p> <p>6. Çmimet, damkosjen dhe shënjimin për grupe kryesore të cilësisë dhe të llojeve të drurit do të përcaktohen nga Ministria.</p> <p>7. Agjencia duhet të ia lëshoj ose refuzoj lejen kërkesit brenda 30 ditësh pas pranimit të kërkesës.</p> <p>8. Përmbajtja e detajuar e lejes për prerje dhe procedura për lëshimin e saj përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.</p>	<p>2. Agjencia vrši doznaku i obeležavanje drveća za seču ili za isto može ovlastiti licencirani subjekat.</p> <p>3. Dozvolu za seču izdaje agencija u skladu sa ovim zakonom i zakonom o opstoj administrativnu proceduru.</p> <p>4. Dozvola za seču u privatnim šumama, osim broja, strukture i obima, zapremine i kvaliteta drvne mase obeležene za seču, kao i uslove i rokove za sprovođenje neophodnih šumskih operacija, određuju se u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>5. Vlasnici privatnih šuma su obavezni da plate određenu taksu za nadoknadu za izdavanje dozvole za seču, uključujući i obeležavanje drveća za seču, koja ne prelazi 10% vrednosti drvne mase na panju, obeležene za seču.</p> <p>6. Cene doznake i obeležavanja za glavne grupe kvaliteta i vrste drveća određuje Ministarstvo.</p> <p>7. Agencija treba izdati ili odbiti dozvolu podnosiocu zahteva u roku od 30 dana nakon prijema zahteva.</p> <p>8. Detaljni sadržaj dozvole za seču i procedura za izdavanje iste određuje se podzakonskim aktom Ministarstva.</p>	<p>2. The Agency shall stamp and mark wood for cutting or may authorize licensed entities.</p> <p>3. The cutting permit shall be issued by the Agency in accordance with this Law and the Law on general administrative procedure.</p> <p>4. In addition to the number, diameter structure, volume, type and quality of the wood measure marked for cutting, the cutting permit for private forests shall contain also conditions, requirements and time limits for performing any necessary forest operations and works, in accordance with this Law.</p> <p>5. Private forest owners are obliged to pay a certain fee as compensation for the issuance of permit for cutting which shall cover the marking of trees for cutting and shall not exceed 10% of the stumpage value of the wood mass marked for cutting.</p> <p>6. The stamping and marking prices per main wood quality and tree species groups shall be determined by the Ministry.</p> <p>7. Agency must issue or refuse the permit to the applicant within 30 days after acceptance of the request.</p> <p>8. Detailed contents of cutting permits and the procedure for issuing them shall be established by sub legal act of the Ministry.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 59 Leja për prerje në pyjet shtetërore</p> <p>1. Agjencia lëshon lejen për prerje në pyje shtetërore për furnizim të popullatës lokale me dru zjarri dhe nevoja të tjera.</p> <p>2. Leja për prerje lëshohet pasi që drunj të jenë të damkosur apo shënuara paraprakisht dhe pas kryerjes së pagesës për vlerën e drunjëve.</p> <p>3. Leja për prerje në pyjet publike brenda territorit të parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura të natyrës lëshohet nga Agjencia në pajtim me Nenin 50 të këtij Ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Član 59 Dozvola za seču u državnim šumama</p> <p>1. Agencija izdaje dozvolu za seču u državnim šumama za snabdevanje lokalnog stanovništva sa drvom za ogrev i druge potrebe.</p> <p>2. Dozvola za seču se izdaje nakon izvršene doznake ili obeležavanje i nakon plaćanja vrednosti za drva.</p> <p>3. Dozvola za seču u javnim šumama unutar teritorije nacionalnih parkova i zaštićenih područja prirode izdaje se od strane Agencije u skladu sa članom 50 ovog zakona.</p>	<p style="text-align: center;">Article 59 Permit for cutting in state forests</p> <p>1. The Agency issues permit for cutting wood in state forests in order to satisfy needs of local people for firewood and other needs.</p> <p>2. Permit for cutting shall be issued after the trees are preliminary stamped or marked and after the payment of trees value is made.</p> <p>3. Permit for cutting in public forests within the territory of national parks and natural protected areas is issued by the Agency in accordance with the Article 50 of this law.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 60 Kushtet për transport të drurit</p> <p>1. Ndalohet transportimi i produkteve drunore pa damkë pyjore dhe fletë përcjellëse të transportit.</p> <p>2. Damkosja e asortimenteve drunore dhe lëshimi i dokumentit për transport, bëhet nga personi i autorizuar nga Agjencia, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>3. Personit, i cili transporton produkte drunore pa damkë pyjore dhe pa fletë përcjellëse për transport, i sekuestrohet automjeti transportues dhe produktet drunore.</p> <p>4. Automjeti transportues dhe mjetet me të cilat është kryer vepra e kundërligjshme, i dorëzohen</p>	<p style="text-align: center;">Član 60 Uslovi za transport drveta</p> <p>1. Zabranjuje se transport drvnih proizvoda bez šumskog žiga i bez propratnice za transport.</p> <p>2. Obeležavanje drvnih sortimenata i izdavanje dokumentacije za transport, vrši se od strane lica koje ovlašćuje Agencija, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>3. Osobi, koja prevozi drvne proizvode bez šumskog žiga i bez propratnice za transport, oduzima se prevozno sredstvo i drvni proizvodi.</p> <p>4. Prevozno sredstvo i sredstva sa kojim je kirivčno delo izvršeno, predaju se nadležnom</p>	<p style="text-align: center;">Article 60 Conditions for transport of wood</p> <p>1. The transport of wood products without forest stamp for transport and without an accompanying transport document is forbidden.</p> <p>2. Marking/stamping of the wood assortments and issuing the transport document is done by the authorized person of the Agency in accordance with this law.</p> <p>3. The person, who transports wood products without a forest stamp and without a transport permit, has the transport vehicle and wood products seized.</p> <p>4. The transport vehicle and tools used for implementing the illegal activity will be given</p>

<p>organit kompetent për ruajte.</p> <p>5. Kthimi i automjetit dhe mjeteve nga paragrafi 6, i këtij neni te pronari, bëhet pas pagesës së gjobës.</p> <p>6. Masa drunore e vendosur në depo për shitje duhet të ketë damkë transporti dhe dokumentacionin si dëshmi për prejardhjen.</p> <p>7. Depoja për vendosjen dhe shitjen e masës drunore duhet të jetë e regjistruar.</p> <p>8. Produktet drunore të deponuara, mund të ritransportohet me dokumentacion të subjektit juridik, në përputhje me pikat 6 dhe 7 të këtij neni.</p> <p>9. Ministria me akt nënligjor përcakton përmbajtjen e dokumentit shoqërues të transportit, mënyrën, kushtet dhe procedurat për monitorim dhe kontrollim të transportit të produkteve drunore.</p>	<p>telu na çuvanje.</p> <p>5. Vraçanje vozila i sredstava iz stava 6, ovog člana, vrši se nakon plaćanja kazne.</p> <p>6. Drvena masa koja je deponovana u skladištu za prodaju, treba posedovati žig za transport i dokumentaciju kao dokaz o poreklu.</p> <p>7. Skladište za odlaganje i prodaju drvene mase treba biti registrovano.</p> <p>8. Skladišteni drveni proizvodi se mogu ponovo ransportovati dokumentacijom pravnog subjekta, u skladu sa tačlama 6. i 7. ovog člana.</p> <p>9. Ministarstvo podzakonskim aktom određuje sadržaj pratećeg dokumenta za prevoz, uslove i procedure za nadgledanje i kontrolisanje prevoza drvnih proizvoda.</p>	<p>to the competent bodies for safeguarding.</p> <p>5. Vehicles and tools seized under Paragraph 6, of this Article shall be returned to their owners after the payment of the compensation fee.</p> <p>6. Wood products placed in a warehouse for sale shall have the transport mark (stamp) and be accompanied by the transport document as proof of origin.</p> <p>7. Warehouse for deployment and selling of wood measure shall be registered.</p> <p>8. Stored wood products may be re-transported with the documentation of the legal entity, in compliance with paragraphs 6 and 7 of this article.</p> <p>9. The required contents of transport document and manner, conditions and procedures for monitoring and control of the transport of wood products shall be established by sub – legal act of the Ministry.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 61 Energjia nga biomasa pyjore</p> <p>1. Për prodhimin e energjisë së ripërtërishme, mund të shfrytëzohet biomasa pyjore dhe masa drunore, në veçanti:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Drunjte e hollë nën 10 cm te halorët dhe 7 cm te gjethorët nga prerjet e rrallimet pyjore;</p>	<p style="text-align: center;">Član 61 Energija iz šumske biomase</p> <p>1. Za proizvodnju obnovljive energije, može se koristiti šumska biomasa i drvena masa, posebno:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Tanka drva ispod 10 cm od četinarara, i 7 cm od liscara od seče i proređivanja;</p>	<p style="text-align: center;">Article 61 Forest biomass and wood for energy</p> <p>1. For production of renewable energy, forest biomass and the following wood mass may be used:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Thinner wood under 10 cm for coniferous and above 7 cm for broadleaves from forest thinning;</p>

<p>1.2. Drunjtë e cilësisë së ulët apo drunjtë e dëmtuar nga prerjet sanitare dhe kultivuese, si edhe nga konvertimet e pyjeve të degraduara;</p> <p>1.3. Drunjtë nga kulturat dhe plantacionet pyjore të ngritura për prodhim të biomasës.</p> <p>2. Mbështetjet financiare mund të sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës për të promovuar prodhimin e qëndrueshëm të masës drunore në pyje private sipas nënparagrafit 1. 2 të këtij neni.</p> <p>3. Për transportin e biomasës pyjore nga pyjet dhe tokat pyjore, fletë-përcjellësja e transportit është e nevojshme.</p>	<p>1.2. Drva slabijeg kvaliteta, oštećena ili drva od sanitarnih ili od sece nege, kao i drva iz konverzije degradiranih šuma;</p> <p>1.3. Drva od šumskih zasada i šumskih plantacija podiglih za proizvodnju biomase.</p> <p>2. Finansijske podrške se mogu obezbediti iz budžeta Republike Kosova za održivo promovisanje drvne mase u privatnim šumama na osnovu tačke 1. 2 ovog zakona.</p> <p>3. Za prevoz šumske biomase iz šuma i šumskog zemljišta, neophodan je prateći dokument za transport.</p>	<p>1.2. Low quality or damaged wood from sanitary and cultivation cuttings, as well as from conversions of degraded forests;</p> <p>1.3. Wood from forest crops and plantations established for production of biomass.</p> <p>2. Financial supports may be provided from the budget of the Republic of Kosovo in order to promote sustainable production of wood mass in private forests under sub - paragraph 1.2 of this Article.</p> <p>3. For transport of the forest biomass from the forests and forest land, an accompanying transport document is needed.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 62 Kushtet për përpunim primar të drurit</p>	<p style="text-align: center;">Član 62 Uslovi za primarnu preradu drveta</p>	<p style="text-align: center;">Article 62 Conditions for primary processing of wood</p>
<p>1. Subjektet e regjistruara dhe të licencuara mund të bëjnë përpunimin primar të drurit në çoftë se stabilimentet në të cilat bëhet përpunimi primar i drurit i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike.</p> <p>2. Stabilimentet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të vendosen vetëm në vendet e caktuara sipas rregullave të parapara nga organi kompetent komunal, si dhe në harmoni me planin urban dhe zhvillimor komunal.</p> <p>3. Stabilimentet për përpunimin primar të drurit nuk mund të vendosen në pyje apo deri në 100 metra afër pyjeve.</p>	<p>1. Registrovani i licencirani subjekti mogu vršiti primarnu preradu drveta, ukoliko postrojenja u kojima se vrši primarna prerada drveta ispunjavaju utvrđene tehničke uslove.</p> <p>2. Postrojenja iz stava 1 ovog člana mogu se postaviti samo na mestima određenih u skladu sa pravilima predviđenih od strane nadležnog opštinskog tela, kao i u skladu sa opštinskim urbanim i razvojnim planom.</p> <p>3. Postrojenja za primarnu preradu drveta se ne smeju postaviti u šumama ili do 100 metara blizu šuma.</p>	<p>1. Registered and licensed entities may perform primary processing of wood, if the facilities where the primary processing of wood is carried out fulfill technical.</p> <p>2. The facilities referred to in Paragraph 1 of this Article may be established only in places that are approved by the responsible municipal authority, and with the municipal urban and development plan.</p> <p>3. Facilities for primary processing of wood shall not be placed in forests or closer than 100 meters to the forests.</p>

<p>4. Në sharra dhe në stabilimentet tjera ndalohet përpunimi primar i drurit që nuk është i damkosur me damkën pyjore për transport dhe pa fletë përcjellëse.</p> <p>5. Pronari i stabilimenteve nga paragrafi 1 i këtij neni obligohet të mbajë librin e evidencës për sharrimin e lëndës teknike që është prodhuar në objektin e njëjtë.</p> <p>6. Kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni si dhe mënyra e mbajtjes së librit të sharrimit përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p>	<p>4. Na testerama i ostalim postrojenjima, zabranjuje se primarna prerada drveta koje nije doznaceno šumskim žigom i bez propratnice za transport.</p> <p>5. Vlasnik postrojenja iz stava 1 ovog člana obavezan je da vodi knjigu evidencije za seču tehničke mase koja je proizvedena u istom objektu.</p> <p>6. Uslovi iz stava 1 ovog člana kao i načini kako voditi knjigu seče, određuje se podzakonskim aktom Ministarstva.</p>	<p>4. In sawmills and other processing facilities, it is forbidden to perform primary processing of wood which is not marked with the forestry transport mark, and is without the accompanying transport document.</p> <p>5. The owner of any facility referred to in Paragraph 1 of this Article shall keep records of raw wood that has been processed in the same facility.</p> <p>6. Conditions under Paragraph 1 of this Article, as well as the manner of keeping records of processed wood shall be defined by sub legal act of the Ministry.</p>
